



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

KOMENTET E AMBASADORIT WOLLFARTH PAS TAKIMIT TË AMBASADORËVE TË OSBE-së, BE-së DHE SHBA-së ME KRYETARIN E PS-së

Tiranë, 23 janar 2013

Z. Ambasador, dimë se z. Rama ju njohu me disa shqetësime lidhur me përgatitjen e zgjedhjeve. Ç'mendim keni për këto shqetësime?

Ambasadori Wollfarth: Përgatitja e zgjedhjeve sipas legjislacionit në fuqi është e një rëndësie maksimale. Të gjitha partitë, jo vetëm Partia Socialiste, duhet të jenë të interesuara për këtë. Përgatitjet po vijnë. Ato përfshijnë edhe elementet elektronike që lidhen me numërimin dhe kartat e identitetit. Këto përgatitje, si dhe zgjedhjet, duhet të zhvillohen në mënyrë konstruktive sa u takon çështjeve që çojnë në një të ardhme më të paqte për Shqipërinë, mes tyre: shteti i së drejtës, zhvillimi i mirë i çështjeve sociale dhe i ekonomisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po punon; parlamenti është momentalisht duke diskutuar në një komision, pra po punon dhe çdo gjë që është konstruktive ka mbështetjen tonë. Kjo është e rëndësishme për zhvillimin e Shqipërisë, për të ardhmen e Shqipërisë dhe për integrimin e Shqipërisë në strukturat ekzistuese në Evropë.

Zhvilluam një bisedë shumë konstruktive me kryetarin e Partisë Socialiste, z. Edi Rama, për këto çështje. Çdo gjë që i shmanget kësaj mund të çonte në një atmosferë më pak konstruktive dhe ne shkurajojmë shikimin drejt gjërave të dëmshme. Dialogu ka filluar dhe do të vijojë.

Z. Ambasador, e diskutuat çështjen e tri ligjeve me z. Rama? A ka një qëndrim të ri lidhur me to?

Ambasadori i BE-së, Ettore Sequi: Nuk diskutuam për këtë çështje.

A diskutuat për shpërndarjen e mandateve me z. Rama dhe cili është qëndrimi juaj?

Ambasadori i BE-së, Ettore Sequi: Mendoj se Ambasadori Wollfarth e shpjegoi me saktësi dhe rrjedhshmëri përmbajtjen e bisedës. Pra, diskutuam për disa çështje që lidhen me procesin zgjedhor dhe me përgatitjen e zgjedhjeve.

Fund